

Politikat e privatësisë

Nëpërmjet kësaj Politike Privatësie, DPD ju informon se si autoriteti ynë mbledh dhe përdor të dhënat personale të individëve, vizitorëve, kandidatëve që marrin pjesë në procesin e rekrutimit të nëpunësve/punonjësve të ardhshëm të sistemit doganor, individëve që ankohen në lidhje me problematikat apo mbarëvajtjen e shërbimeve që ofrojmë etj, dhe ku përpunimi i të cilave kryhet pas dhënies së pëlqimit nga subjekti i të dhënave personale dhe/ose në rastet e tjera të parashikuara si nga Ligji nr.104/2014, datë "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ashtu edhe nga ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

Ky dokument ka për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale mbi mënyrën e grumbullimit, përpunimit, përhapjes, ruajtjes së privatësisë dhe masave të sigurisë, për të dhënat e përpunuara nga faqja jonë "web", procese të cilat realizohen në përputhje të plotë me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe nënligjor, për mbrojtjen e të dhënave personale.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave garanton çdo subjekt se të dhënat e tij doganore apo personale të administruara prej saj do të trajtohen në përputhje të plotë dhe konform parashikimeve të Ligjit 104/2014, datë "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar., rregullores së brendshme për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës doganore, si dhe çdo akti ligjor dhe nënligjor në fuqi që rregullon ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve nga njësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Baza ligjore:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
- Ligjin Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike dhe postare" si dhe aktet e tjera nënligjore në plotësim.
- Udhëzimin nr. 47 datë 14.09.2018 të komisionierit "Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjekte përpunuese të mëdha.
- Rekomandimi i komisionierit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, nr. 2, datë 11.05.2020 "Për publikimin e 'politikave të privatësisë' në faqet zyrtare të internetit nga institucionet e administratës shtetërore".
- Rregullorja "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjishëm, viti 2022.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si pjesë e administratës shtetërore është subjekt përpunues i madh i të dhënave personale, në kuptim të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

DPD ka si detyrim plotësimin e të gjitha parashikimeve të mësipërme ligjore në kryerjen e grumbullimit, përpunimit të të dhënave personale duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti, të drejtën e ruajtjes së privatësisë.

Mbrojtja e të dhënave personale bazohet në:

- përpunimin në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe të ligjshme të informacionit doganor;
- në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime të dhënave doganore;

- në saktësinë nga ana faktike dhe, kur është e nevojshme, përditësimin e kryerjen e çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta e të parregullta të fshihen apo të ndryshohen;
- në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar.

Dhënia e informacionit (doganor) nga administrata doganore

Informacioni i administruar nga administrata doganore, u ofrohet pa pagesë autoriteteve të përcaktuara, pas depozitimit të kërkesës me shkrim dhe kur verifikohen rrethanat e mëposhtme:

- gjyqtarit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje civile, të lidhur me një subjekt, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën doganore;
- gjyqtarit apo prokurorit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje penale, të lidhur me një subjekt, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën doganore;
- Kontrollit të Lartë të Shtetit, vetëm për rastet, kur kërkesa e bërë është në funksion të kontrollit të kryer nga ky institucion ndaj administratës doganore, në funksion të hartimit të rekomandimeve të veta;
- autoritetit të ngjashëm të huaj, me të cilin Kuvendi ka ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare dhe informacioni kërkohet në kuadër të ekzekutimit të marrëveshjes;
- autoritetit homolog të huaj ose autoriteteve vendase, me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe, me objekt shkëmbimin e informacionit;
- institucioneve të pavarura, të krijuara me ligj;
- çdo autoriteti tjetër, sipas parashikimit të bërë me ligj të veçantë.

Përpunimi i të dhënave personale bëhet:

- për të mbrojtur interesat jetike të subjektit të të dhënave;
- për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit;
- për mbrojtjen e interesave jetësore të subjektit të të dhënave;
- për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
- për përmbushjen e një kontrate, për të cilën subjekti i të dhënave personale është palë kontraktuese, apo për ndryshime të një kontrate me propozimin e subjektit të të dhënave.

Kategoritë e të dhënave personale

Të dhënat personale që grumbullohen dhe përpunohen nga kontrolluesit, janë të dhëna sensitive dhe të dhëna të përbashkëta. Për të dhëna sensitive ekziston detyrimi i veçantë për kontrolluesin (përpunuesin) që të marrë pëlqimin me shkrim të subjektit të të dhënave personale.

Transferimi i të dhënave

Subjekti kontrollues kryen transferim ndërkombëtar të të dhënave personale, me pëlqim të subjekteve të të dhënave personale në vende me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes të të dhënave personale, bazuar në parashikimet e nenit 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9887/2008 dhe aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij.

Me pëlqim të subjekteve të të dhënave personale, transferohen të dhëna në shtete që nuk sigurojnë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, por që autorizohet nga akte ndërkombëtare, të ratifikuara nga RSH dhe që janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë si dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit, të lidhura nga Ministria e Mbrojtjes, me kusht që këto të dhëna të trajtohen dhe të ruhen, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Të drejtat e subjektit të të dhënave

Subjekti i të dhënave personale ka të drejtë që të njihet në çdo kohë me të dhënat e tij personale të grumbulluara dhe të përpunuara, nga kontrolluesi.

Subjekti i të dhënave personale informohet nga kontrolluesi për kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, qëllimin, mënyrën si dhe çdo informacion tjetër për të siguruar një përpunim të drejtë.

E drejta për akses dhe informim

Subjekti i të dhënave personale ka të drejtë të kërkojë akses mbi të dhënat e tij, kur informohet se të dhënat e tij po përpunohen;

- të kërkojë bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, me kërkesë, pa pagesë, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë grumbulluar dhe përpunuar në kundërshtim me dispozitat e ligjit;
- të informohet nga kontrolluesi brenda 30 ditëve, për kryerjen ose jo të të bllokimit, korrigjimit ose fshirjes, duke u dhënë shpjegimet përkatëse;
- të kundërshtojë, në çdo kohë, mbështetur në ligj, përpunimin e të dhënave rreth tij, sipas shkronjave "d" dhe "dh" të nenit 6, të ligjit nr. 9887/2008, përveç kur parashikohen ndryshime me ligj;
- të ankohet në rast se pretendon që i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, pranë administratës tonë ose të njoftojë komisionerin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij.

Siguria e të dhënave personale

Subjekti kontrollues është i ndërgjegjshëm për rëndësinë dhe sensitivitetin e të dhënave personale, me staf të përkushtuar, të trajnuar në njohjen e kuadrit ligjor dhe i certifikuar për këtë qëllim.

Të dhënat personale të subjekteve përpunohen në mënyrë manuale dhe elektronike, në zbatueshmëri të plotë me masat e sigurisë fizike të informacionit dhe sigurisë elektronike nga skedarët spiun, të përcaktuara në rregullore dhe udhëzime të veçanta.

Kontrolluesit, përpunuesit e tjerë të të dhënave personale, janë të kufizuar dhe kontrolluar nga kontrolluesi kryesor i përpunimit të të dhënave personale.

Në momentin e aplikimit, aplikantëve ju bëhet e ditur, afati i ruajtjes së të dhënave personale. Të dhënat personale të aplikantëve që nuk shpallen fitues, ruhen deri në përfundimin e afatit të përcaktuar, më pas shkatërrohen (asgjësohen) dhe fshihen nga sistemi.

Çdo person që vepron nën autoritetin e DPD-së, përpunon të dhëna personale, nënshkruan një deklaratë kofidencialiteti, me anë të së cilës angazhohet se do të zbatojë kërkesat e ligjit dhe të

kësaj politike për ruajtjen e privatësisë, dhe sigurinë e të dhënave personale gjatë ushtrimit të detyrës dhe pas mbarimit të saj.

Të tjera

DPD identifikon adresat dhe numrat e kontakti të subjekteve të të dhënave, për qëllime të caktuara apo të ndonjë ankese nga ana e tyre.

DPD i mundëson subjektit të të dhënave personale të drejtën e refuzimit me shkrim të pëlqimit të dhënë, në çdo kohë.

DPD kërkon miratimin (pëlqimin) nga subjekti i të dhënave personale që ky i fundit ka marrë dijeni dhe jep pëlqimin për përpunimin e të dhënave sipas përcaktimeve në politikën e privatësisë.

DPD ruajnë privatësinë e të dhënave personale, përditësimin e politikës së privatësisë herë pas herë, duke njoftuar edhe subjektet e të dhënave për ndryshimet e realizuara.

Konfidencialiteti

Nëpunësit dhe punonjësit e administratës doganore, qendrore, dhe degët doganore, ruajnë konfidencialitetin e të dhënave doganore (dhe financiare) të subjekteve (individ/biznes), që i kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrës. Kjo pikë nuk zbatohet për detyrimet doganore, për të cilat kanë filluar procedurat e mbledhjes me forcë.

Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit vazhdon edhe pasi nëpunësi apo punonjësi nuk është më i punësuar pranë administratës doganore, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Informacioni i lidhur me subjektet përdoret brenda administratës doganore, vetëm në masën e kërkuar për administrimet doganore.

Kushti i ruajtjes së konfidencialitetit përfundon në rastet kur subjekti personalisht heq dorë, me shkrim, nga e drejta e tij për ruajtjen e konfidencialitetit dhe për aq sa është e lejuar në deklarin e bërë nga subjekti.

Shkëmbimi i informacionit, i bërë në ekzekutim të marrëveshjeve të lidhura nga administrata doganore, bëhet me kushtin e ruajtjes së konfidencialitetit për institucionet dhe individët, që marrin dijeni për të dhënat doganore.

Administrata doganore është përgjegjëse për zbatimin e këtyre kërkesave në të gjitha përpunimet automatike ose me mjete të tjera të të dhënave, për aq sa është parashikuar nga dispozitat në fuqi që mbulon fushën në fjalë

LIDHJET ME FAQET E TJERA

Ky njoftim mbi ruajtjen e privatësisë për të arritur mbrojtjen e të dhënave personale nuk përfshin lidhjet midis kësaj faqeje dhe faqeve të tjera. Ne ju inkurajojmë të lexoni deklaratat e privatësisë në faqet e tjera të internetit që ju vizitoni.

NDRYSHIMET NË KËTË NJOFTIM MBI MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Ne përditësojmë këtë njoftim në mënyrë të rregullt duke vlerësuar këtë politikë të privatësisë si ndër më të rëndësishmet në veprimtarinë e punës së DPD-së.

Kontakt:

*Drejtoria e Pergjithshme e Doganave
Tiranë, Kasha Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1, Qendra "Pajtoni
Bussines Center", kati 5.*

Tel: +355 42 232 988

Email: helpdesk.dpd@dogana.gov.al

RREGULLORE PËR “MBROJTJEN, PËRPUNIMIN, RUAJTJEN DHE SIGURINË E TË
DHËNAVE PERSONALE”

Neni 1 ***Objekti***

Objekti i kësaj Rregullore është përcaktimi i procedurave organizative e teknike, masave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurisë, ruajtjes dhe administrimit të të dhënave personale nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD).

Neni 2 ***Qëllimi***

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e disa rregullave në bazë të cilave DPD mbron të dhënat personale të subjekteve dhe punonjëseve (ose aplikanteve) të tij, nga keqpërdorimi i këtyre të dhënave nga cilido person i pa autorizuar dhe në çfarëdo mënyre jo konform me aktet ligjore dhe nënligjore “Për mbrojtjen e të Dhenave Personale” i ndryshuar dhe me politikat e brendshme të autoritetit.

Neni ***Përkufizime***

- a) Për qëllim të kësaj Rregullore, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim: “Kontrollues” Për efekt të kësaj rregulloreje janë punonjësit e DPD-së të cilët, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.
- b) Termat e tjerë të përdorur në zbatim të kësaj Rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si më ligjin në fuqi “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Neni 4 ***Fusha e zbatimit***

Kjo Rregullore zbatohet për përpunimin e të dhënave personale plotësisht ose pjesërisht, nëpërmjet mjeteve automatike, dhe me mjete të tjera që mbahen në një sistem arkivimi apo kanë për qëllim të formojnë pjesë të sistemit të arkivimit pranë DPD-së.

Neni 5 ***Mbrojtja e të dhënave personale***

Çdo punonjës i DPD-së, që merret me përpunimin e të dhënave personale të subjekteve, detyrohet të zbatojë kërkesat e ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”,

Neni 6 ***Qëllimi i përpunimit***

Çdo punonjës i DPD-së duhet t’i përdorë të dhënat personale vetëm për kryerjen e detyrave të parashikuara nga ligji dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë mënyrën e përpunimit të të dhënave personale.

Neni 7

Kriteret e përpunimit të të dhënave personale

Punonjësit e çdo strukture të DPD-së që përpunojnë të dhëna personale të subjekteve, bazohen në kriteret e përcaktuara në nenin 6 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Neni 8

Përpunimi i të dhënave sensitive

Përpunimi i të dhënave sensitive, kryhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 7 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Neni 9

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave

Në rast të kryerjes së transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale çdo punonjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave zbaton parashikimet e nenit 8 dhe 9 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij si Udhëzimi nr.41, dt.13.6.2014 “Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”, Udhëzuesi mbi transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale si dhe Vendimin nr.3, dt.20.11.2012 “Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

Neni 10

Zbatimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale

Përhapja ose komunikimi i të dhënave personale kryhet në përputhje me qëllimin për të cilin janë grumbulluar këto të dhëna. Çdo person ka të drejtë që të njihet me të dhënat personale të përpunuara nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Çdo punonjës i DPD-së që përpunon të dhëna personale është i detyruar që në bazë të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, të zbatojë të drejtat e subjekteve të të dhënave personale:

Neni 11

Kërkesa për informacion

Kërkesën për informacion mund ta bëjë:

- Vetë personi ;
- Përfaqësuesi ligjor i pajisur me autorizimin përkatës;
- Persona të tjerë të cilët megjithëse nuk kanë interes të drejtpërdrejtë, provojnë se kanë një interes të ligjshëm për të marrë dijeni në lidhje me këto të dhëna dhe që përputhet me qëllimin e grumbullimit të këtyre të dhënave;

Përgjigja në çdo rast dërgohet në adresën e kërkuar nga vetë kërkuuesi.

Neni 12

Masat për sigurinë e të dhënave

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për

të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

DPD merr këto masa të veçanta sigurie:

- a) Përcakton funksionet ndërmjet njësive organizative dhe operatorëve për përdorimin e të dhënave;
- b) Përdorimi i të dhënave bëhet me urdhër të njësive organizative ose të operatorëve të autorizuar;
- c) Udhëzojnë operatorët, pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave;
- d) Aksesin në të dhënat dhe programet, bëhet vetëm nga personat e autorizuar, ndalojnë hyrjen në mjetet e arkivimit dhe përdorimin e tyre nga persona të paautorizuar;
- e) Vënia në punë e pajisjeve të përpunimit të të dhënave bëhet vetëm nga personat e autorizuar dhe çdo mjet sigurohet me masa parandaluese ndaj vënies së autorizuar në punë;
- f) Regjistrojnë dhe dokumentojnë modifikimet, korrigjimet, fshirjet, transmetimet, përditësimet, etj.
- g) Sa herë që punonjësit e DPD-së largohen nga vendi i tyre i punës, ata duhet të mbyllin kompjuterat e tyre, dollapët, kasafortat dhe zyrën, në të cilat janë ruajtur të dhënat personale ;
- h) Nuk duhet të largohen nga mjediset e punës kur ka të dhëna të pambrojtura në tavolinë, dhe ndodhet në prani të personave të cilët nuk janë të punësuar nga ana e DPD-së;
- i) Nuk mbajnë në monitor të dhëna personale, kur është i pranishëm një person i paautorizuar dhe sidomos në vende jo publike;
- j) Nuk nxjerrin jashtë zyrës, në asnjë rast, kompjutera, laptop, flesh apo pajisje të tjera që përmbajnë të dhëna personale dhe nuk duhet ti lënë ato në vende të pasigurta, pa u siguruar për fshirjen apo shkatërrimin e të dhënave;
- k) Të dhënat të mbrohen duke verifikuar identitetin e përdoruesit dhe duke i lejuar akses vetëm individëve të autorizuar.
- l) Udhëzimet për përdorimin e kompjuterit, duhet të ruhen në mënyrë të tillë që ato të mos jenë të aksesueshme nga persona të paautorizuar;
- m) Kryejnë vazhdimisht procedurën e hyrjes dhe daljes duke përdorur fjalëkalime personale në fillim dhe në mbarim të aksesit të tyre në të dhënat e mbrojtura, të ruajtura në bazat e të dhënave të DPD-së;
- n) Njohja dhe regjistrimi i punonjesve dhe i përdoruesve kryhet me përdorimin e fjalëkalimeve për hyrjen në sistemin e të dhënave. Fjalëkalimet cilësohen sekrete dhe janë vetjake
- o) Në dokumente që përmbajnë të dhëna të mbrojtura, duhet të sigurojnë shkatërrimin e materialeve ndihmëse, (p.sh. provat apo shkresat, matricat, llogaritjet, diagrame dhe skica) të përdorura ose të prodhuara për krijimin e dokumentit;
- p) Të dhënat e dokumentuara nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin e grumbullimit.
- q) Ndalohet njohja ose çdo përpunim i të dhënave të regjistruara në dosje për një qëllim të ndryshëm nga e drejta për të hedhur të dhëna. Përjashtohet nga ky rregull rasti kur të dhënat përdoren për parandalimin ose ndjekjen e një vepre penale.
- r) Ruajnë dokumentacionin e të dhënave për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin, për të cilin është grumbulluar.
- s) Niveli i sigurisë duhet të jetë i përshtatshëm me natyrën e përpunimit të të dhënave

personale.

t) Respektojnë aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë se si duhet të përdoren të dhënat personale.

Neni 13

Mbrojtja e ambjenteve

Ambientet në të cilat do të përpunohen të dhënat personale duhet të mbrohen nga masa organizative, fizike dhe teknike që të parandalojnë aksesin e personave të paautorizuar në mjediset dhe aparaturat me të cilat do të përpunohen të dhënat personale. Zbatimi i masave të sigurimit duhet të bëhet në përputhje me nivelin e sigurisë së të dhënave dhe informacionit të administruar, si dhe treguesit e nivelit të rrezikut që mund të vijë nga ekspozimi i paautorizuar i informacionit të ruajtur.

Në ambientet ku përpunohen të dhëna personale zbatohen këto masa sigurie:

- Ndalohet hyrja e personave të paautorizuar.
- Personat që futen në këto ambjete duhet të pajisen me autorizimin përkatës, e percaktuar Lista Emerore
- Ambientet e hyrjes, survejohen me kamera gjatë 24 orëve.
- Veç masave dhe sistemeve të tjera të mbrojtjes, vendosen pajisje dhe sisteme të sigurimit elektronik (sisteme sinjalizimi, telekamera, etj).
- Ambientet pajisen me dollap hekuri, të sigurt për mbrojtjen e dosjeve nga dëmtimi i tyre, me kasaforta e brava automatike me çelësa dhe drynë të veçantë nga ata të përdorimit të zakonshëm dhe vulosen me dyllë ose plastelinë.
- Dyert të jenë të blinduara dhe dritaret të përforcohen me shufra hekuri.
- Sigurohet mbikëqyrje e vazhdueshme, ditën dhe natën me roje fizike.

Neni 14

Mbrojtja e pajisjeve elektronike

Pajisjet elektronike për përpunimin e të dhënave dhe informacioneve në DPD përdoren vetëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara në rregullore. Këto pajisje përdoren vetëm nga punonjës të DPD-së të trajnuar më parë për përdorimin e tyre. Për çdo gabim apo defekt në sistemet/databaset e DPD-së njoftohet administratori i sistemit, i cili mbi bazën e kërkesës bën rregullimin përkatës. Shumë nga aplikimet dhe sistemet kompjuterike janë të mbrojtura me një fjalëkalim. Për arsye sigurie, këto fjalëkalime herë pas here duhet të ndryshohen (çdo 3 muaj ose çdo 6 muaj). Disa rregulla mbi përdorimin dhe vendosjen e fjalëkalimeve:

Neni 15

Monitorimi dhe regjistrimi i aksesit për të dhënat personale

Hyrja tek të dhënat dhe informacionet u nënshtrohet normave të veçanta të sigurisë për ruajtjen e paprekshmërisë dhe për azhurnimin e tyre. Sistemi është i ndërtuar në mënyrë të tillë që vërteton identitetin e përdoruesit. Kjo kërkon që serveri qendror të njohë çdo operator terminalist dhe çdo përdorues nëpërmjet programeve të veçanta. Ky sistem mundëson identifikimin e vazhdueshëm të përdoruesit në çdo kohë, në një terminal të caktuar, vendin e punës ose pajisje të tjera për periudhën për të cilën të dhënat specifike janë ruajtur. Përdoruesit duhet të njihen me llojin e të dhënave në regjistrimet e përditshme dhe kohën e ruajtjes së këtyre regjistrimeve.

Neni 16
Mbrojtja e dokumentave

Dokumentat dhe mjetet e tjera të komunikimit në të cilat mbahen të dhëna personale i nënshtrohen një niveli të caktuar kofidencialiteti. Sekretimi dhe niveli i kofidencialitetit përcaktohet në përputhje me aktet normative në fuqi.

Neni 17
Masat administrative

Çdo punonjës i DPD-së i cili shkel detyrën për të mbrojtur të dhënat personale është përgjegjës për thyerje të disiplinës, rregullave, dhe detyrimeve në veprimtarinë e punës së tij. Në qoftë se veprimet e tyre nuk përbëjnë vepër penale ndaj tyre merren masa administrative dhe disiplinore sipas akteve normative në fuqi.

Neni 18
Mbikëqyrja e masave dhe procedurave mbrojtëse

Mbikëqyrja e implementimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale për respektimin normave të sigurisë, për mbrojtjen e të dhënave të automatizuara kundër prishjes së tyre aksidentale ose të paautorizuar, si dhe kundër hyrjes, ndryshimit dhe përhapjes së paautorizuar të tyre realizohet nga personat përgjegjës për mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të dhënave respektive.

Neni 19
Konfidencialiteti për përpunimin e të dhënave

Çdo punonjës i DPD-së që përpunon të dhëna apo vihet në dijeni me të dhënat e përpunuara nuk mund ti bëjë të njohur përmbajtjen e këtyre të dhënave personave të tjerë. Ai detyrohet të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.